



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE**

Nr. 16707 prot.

Vlorë, më 17.08.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë ____ . ____ 2026

**PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIT TË QIRASË QË PËRFITOJNË FAMILJET NË
NEVOJË, TË CILAT NUK MUND TË PËRBALLOJNË ME TË ARDHURAT E TYRE
QIRANË E TREGUT TË LIRË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar neni 2 pika 34/a,b,c, pika 35, pika 36, pika 42, neni 33, neni 38, të VKM Nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, të VKM Nr.384 datë 12/06/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të VKM Nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si edhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë;

VENDOSI

- I. Të miratojë subvencionin e qirasë që përfitojnë familjet në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë me të ardhurat e tyre qiranë e tregut të lirë, emrat sipas tabelës bashkëlidhur.
- II. Afati i përfitimit të subvencionit të qirasë është 1 vit nga data e paraqitjes së kërkesës së aplikantëve pranë Bashkisë Vlorë.
- III. Efektet financiare sipas pikës I, do të mbulohen nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2026.

- IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, si edhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit pranë Bashkisë Vlorë.
- V. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR
Brunilda Mersini



LISTA E FAMILIEVE / INDIVIDËVE QË PËRITQINË SUBVENCIONIN E QIRASË NË TREG TË LIRË PËR VITIN 2026
grupi i tretë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Kategoria sipas nenit 16 të ligjit nr.22/2018	Përberja familjare	Struktura e ap. sipas normave të strehimit	Superfaqja e ap.m ² sipas kontra- tës qirasë	Qiraja mes.e apart. në treg për strukturën që i takon	Të ardhurat	Kategoria sipas pikës 45 të nenit 2 të ligjit 22/2018	Aftësia përball. e familjes	Qiraja e përball.	Sub- vencioni mujor	Subvencioni vjetor 2026
1	Feruze	Qani	Koçi	E moshuar, Kom.egjipt.	1 garsonierë		75	15000	12099	Ardh.sh.ulta	15%	1815	13185	158220
2	Ismalda	Ibrahim	Isaj	fam.njëpr. -grua e dhun.	3 1+1		93,97	20000	0	0	0%	0	20000	240000
3	Ionida	Xhevair	Toska	familje njëprindërore	3 1+1		85,1	25000	44400	Ardh.sh.ulta	15%	6660	18340	220080
4	Ernest	Festim	Babaçi	familje komun.egjiptian	5 2+1		40	17000	0	0	0%	0	17000	204000
5	Denisa	Azem	Haruni	Në proçes divorci	6 3+1		54,5	20000	42624	Ardh.sh.ulta	15%	6394	13606	163272
6	Luiza	Buran	Çuni	Status verbërie	1 garsonierë		34,83	10000	0	0	0%	0	10000	120000
7	Ermir	Lefter	Qelvanaj	djalit PAK tetraplegji	3 2+1		89	25000	44400	Ardh.sh.ulta	15%	6660	18340	220080
8	Engjëllushë	Sinan	Canaj	e moshuar	1 garsonierë		56	15000	19488	Ardh.sh.ulta	15%	2932	12068	144816
9	Andrea	Selim	Thomai	të moshuar	2 1+1		105,4	15000	30794	Ardh.sh.ulta	15%	4619	10381	124572
10	Nysret	Birçe	Çinaj	familje njëprindërore	2 1+1		52,5	20000	0	0	0%	0	20000	240000
11	Taze	Izet	Mataj	të moshuar	2 1+1		63	15000	24663	Ardh.sh.ulta	15%	3699	11301	135612
													164221	1970652



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 16707 prot.

Vlorë, më 17.08.2026

RELACION

Për projekt-vendimin

PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIT TË QIRASË QË PËRFITOJNË FAMILJET NË NEVOJË, TË CILAT NUK MUND TË PËRBALLOJNË ME TË ARDHURAT E TYRE QIRANË E TREGUT TË LIRË.

Në mbështetje të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 2 pika 34/a,b,c, pika 35, pika 36, pika 42, neni 33, neni 38, të VKM Nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, informojmë se subvencioni i qirasë në treg të lirë është një instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë reale, për të cilën kanë nënshkruar kontratën me personin qiradhënës. Masa e subvencionit të qirasë është në varësi të të ardhurave të familjes. Për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, masa e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100% të vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.107, datë 18.12.2024 “Për miratimin e qirave mesatare në treg të lirë dhe të subvencionit maksimal që përfitojnë familjet pa të ardhura”, janë miratuar vlerat e qirasë mesatare për qytetin e Vlorës si vijon;

Garsonierë	15.000 lekë/muaj
(1+1)	20.000 lekë/muaj
(2+1)	25.000 lekë/muaj
(3+1)	30.000 lekë/muaj

Në formulën llogaritëse $S=Q_m-Q_p$, vlerat e qirasë mesatare merren nga kontratat e qirave, por jo më të mëdha se qiraja mesatare e miratuar sa më lart. Qiraja e përballueshme përcaktohet nga aftësia përballuese e familjes dhe kjo nga të ardhurat mujore neto të çdo familje, % e të ardhurave të familjes ndaj të ardhurave mesatare të përcaktuara nga INSTAT për qarkun Vlorë (Ames, Aulta, Ashulta, A0).

Për vitin 2026 në përmbushje të kërkesave të familjeve/individëve të pastrehë për tu trajtuar me subvencionin e qirasë në treg të lirë nga Bashkia Vlorë, rezulton:

1. Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.29, datë 28.02.2026 janë miratuar 19 familje dhe individë për të përfituar subvencionin e qirasë në treg të lirë, me fondet e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2026 në shumën totale 260739 lekë në muaj, 3128868 lekë në vit.
2. Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.64, datë 28.05.2026 janë miratuar 11 familje dhe individë për të përfituar subvencionin e qirasë në treg të lirë, me fondet e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2026 në shumën totale 149712 lekë në muaj, 1796544 lekë në vit.

Objekt i këtij projektvendimi janë kërkesat qytetarëve, grupi i tretë i aplikantëve për vitin 2026, të cilët banojnë në banesë të marrë me qira në treg të lirë dhe për kushtet familjare, të strehimit, ekonomike dhe sociale, nuk mundet të mbulojnë me të ardhurat që sigurojnë pagesat e qirasë, për të cilën kanë nënshkruar kontratën para noterit me palën qiradhënëse. Sipas nenit 16, të ligjit 22/2018 këto familje dhe individë bëjnë pjesë në kategoritë e mëposhtme:

1. Familje pa të ardhura.
2. Familje me individë PAK.
3. Familje njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç.
4. Të moshuar të vetmuar.
5. Anëtarë të komunitetit egjiptian.

Të gjitha aplikimet e depozituara pranë Bashkisë Vlorë deri në muajin korrik janë përcjellë pranë Komisionit të Strehimit nga struktura përgjegjëse për strehimin në mbledhjen e datës 06 /08/2026. Për aplikimet e paraqitura për herë të parë, pranë komisionit është vendosur edhe procesverbali i verifikimit në fakt të banesave, përputhshmëria e vendndodhjes dhe kushteve reale kundrejt përshkrimit në kontratat e qirasë të nënshkruara midis palës qiramarrëse dhe qiradhënëse. Nga komisioni u vlerësuan kushtet sociale dhe ekonomike në të gjitha rastet, ku të ardhurat familjare për efekt të përcaktimit të qirasë së përballueshme dhe të subvencionit të qirasë, u morën nga mesatarja e periudhës 1 vjeçare para muajit të aplikimit. Për personat në pension të ardhurat merren nga vërtetimet për masën e pensionit të gjeneruara përmes portalit e-albania. Ndërsa familjet/individët përfitues të ndihmës ekonomike, ose të pagesave të aftësisë së kufizuar, konsiderohen me të ardhura zero.

Nisur nga vlerësimi i të gjitha dosjeve dhe përputhshmërisë me kushtet e kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, komisioni vendosi të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë të 11 familjeve. Të dhëna të detajuara për këto familje/individë mbi kushtet e strehimit, sociale, ekonomike, aftësinë paguese, qiranë e përballueshme, subvencionin mujor dhe vjetor që përfitojnë, janë vendosur në tabelën bashkëlidhur këtij projektvendimi.

Sa më lart, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë projektvendimin e paraqitur për të ndihmuar me pagesat e qirasë familjet në nevojë që kërkojnë mbështetje nga Bashkia Vlorë.

Specialiste

Drita Mustafai



DREJTOR

Kristaq Jorgaqi

